

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE

NUMRI **12** MAJ
2022

Përmbledhje e Pikave Kryesore

1. A mund të ndikojë lufta në Ukrainë te krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor?

Lufta në Ukrainë ka vazhduar për dy muaj, me ndikime shkatërrimtare në vend dhe në popull. Kjo luftë po jep efekte të tërthorta edhe jashtë vendit. Në këtë buletin do të shqyrtojmë mënyrën se si lufta në Ukrainë mund të shtojë numrin e mundësive për krimin e organizuar në Ballkanin Perëndimor, si pasojë e trafikimit të armëve, pastrimit të parave, anashkalimit të sanksioneve, lëvizjes së luftëtarëve ose ndonjë ndryshimi të mundshëm të rrugëve të trafikimit.

2. Bosnja dhe Hercegovina është bërë qyteti kyç i tranzitit për trafikimin e armëve në Evropë.

Bosnja dhe Hercegovina është njëherazi vend burimor dhe tranziti për trafikimin e armëve të vogla dhe armëve të lehta. Që prej fundit të luftës së Bosnjës në vitin 1995, vendi ka pasur armë të bollshme. Këtu do të shqyrtojmë se nga vijnë armët, ku shkojnë dhe kush është i përfshirë në këtë biznes që kontribuon në terrorizëm, luftë dhe krim të organizuar.

3. Bërçkoja: Treg për krimin e organizuar.

Në këtë numër, do të përqendrohemi te vatrat e nxehta të Bërçkos në Bosnjën dhe Hercegovinën e veriut. Ky rreth, i cili ndodhet pranë kufijve të Bosnjës me Kroacinë dhe Serbinë dhe që njihet që prej fillimit të viteve 1990 si treg i gjithçkaje, kohëve të fundit ka parë një numër incidentesh që kanë të bëjnë me trafikimin e emigrantëve, armëve dhe drogës. Ne shqyrtojmë këtu faktorët e cënueshmërisë dhe situatën aktuale.

4. Zhvatja në Serbi është e nënvlerësuar dhe raportohet sikur është më pak nga sa është në të vërtetë.

Ka pasur raporte sipas të cilave në Serbi ka zhvatje, fajde dhe dallavere, por sa i madh është ky problem? Një studim i ri, i realizuar falë një burse të dhënë nga Fondi i Qëndrueshmërisë i Iniciativës Globale kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), tregon se problemi është i nënvlerësuar dhe raportohet më pak nga sa duhet.



5. Pretendimet për foshnja të zhdukura vazhdojnë të jenë makthi i Serbisë.

Pretendohet se gjatë disa dekadash, nga maternitetet e Serbisë janë zhdukur mijëra foshnja të cilat u janë shitur prindërve që donin të adoptonin fëmijë. Kjo

tregti tronditëse doli në dritë si rezultat i një rasti kundër Serbisë, të ngritur në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Si është e mundur një praktikë e tillë, sa e organizuar është ajo dhe çfarë po bëhet për t'i dhënë zgjidhje?

RRETH KËTJË NUMRI

Mirë se vini në numrin e 12-të të "Buletinit të rreziqeve", i cili botohet nga Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore të GI-TOC-së.

Si shumë të tjerë, edhe ne jemi të tronditur thellë nga ngjarjet e tmerrshme që kanë ndodhur e po ndodhin në Ukrainë. Ajo që na shqetëson është edhe ndikimi i luftës, si në Ukrainë ashtu edhe tek populli ukrainas, por edhe ndikimet "jehonë" që mund të ndihen gjetkë. Në harmoni me misionin tonë, ne i kushtojmë vëmendje të veçantë ndikimit të mundshëm të luftës të krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor. Sikurse vepruam në rastin e pandemisë "KOVID-19", ne do t'i monitorojmë nga afër pasojat që lufta në Ukrainë ka tek ekonomitë e paligjshme të Evropës Juglindore.

Flitet shpesh për mënyrën se si armët nga Ballkani Perëndimor kontrabandohen për t'u përdorur, për shembull, nga grupet kriminale ose terroristët në Evropën Perëndimore. Në këtë buletin, do ta shohim këtë problem më nga afër duke u përqendruar te rasti i Bosnjës dhe Hercegovinës. Ndonëse kemi qenë në dijeni për faktin që armët që janë trashëgimi e luftës së Bosnjës kontrabandohen në tregun e zi, ne u habitëm kur mësuam se Bosnja dhe Hercegovina ishte edhe vend tranziti. Më tej, arrestimet dhe konfiskimet e realizuara së fundmi përbëjnë provë që dëshmon për bashkëpunimin ndërkombëtar, edhe nga kriminelët, edhe nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Kjo sipas të vërtetave të zbardhura nga disa hetime të kryera kohëve të fundit.

Sikurse veprojmë në çdo numër buletini, edhe kësaj radhe do të përqendrohemi te një vatër e nxehtë e krimi të organizuar. Këtë herë, kjo vatër është Bërçkoja në Bosnjën dhe Hercegovinën e veriut. Duke u mbështetur në intervista dhe vërtetime të drejtpërdrejta, ne do të shpjegojmë faktorët e cënueshmërisë dhe tipat e trafikimit që mbizotërojnë në këtë rajon të vogël, si dhe problemet e korrupsionit në radhët e policisë.

Falë një burse të Fondit e Qëndrueshmërisë të GI-TOC-së, Milos Katići (Milos Katić) nga Vojvodina e Serbisë realizoi një hulumtim shkencor në lidhje me zhvatjen dhe fajden në këtë shtet. Do të profilizojmë edhe disa prej gjetjeve kryesore të këtij hulumtimi, të publikuara në dhjetor të vitit 2021.

Gjatë viteve të fundit, media serbe ka publikuar raporte për foshnjat e zhdukura. Edhe pse shumica e rasteve që jemi duke shqyrtuar kanë ndodhur dekada më parë, me sa duket, vjedhja dhe kontrabandimi i bebeve dhe madje i embrioneve mund të vazhdojë të jetë problem në një numër shtetesh, ku shfaqen karakteristikat e krimi të organizuar.

Kohëve të fundit kemi publikuar një raport për prurjet financiare të paligjshme (PFP) në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, i cili vjen pas publikimit të një vlerësimi të ngjashëm që kemi kryer në vitin 2020 ku analizuam faktorët kryesorë nxitës dhe prirjet aktuale të PFP-ve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut.¹ Në raport vihet në dukje nevoja për rritjen e informimit për ndikimin dhe dëmin që shkaktojnë PFP-të dhe për rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile për të hetuar dhe rritur vetëdijësimin për këto lloje krimi. Shpresojmë që të përqendrohemi te këto tema në të ardhmen.

Ne kërkojmë vazhdimisht mënyra të reja përmes të cilave mund të paraqesim punën tonë. Prandaj, kemi projektuar një platformë ndërvepruese në internet për të vënë në dukje disa prej të dhënave dhe gjetjeve kryesore të raporteve tona. Vizualizimi i parë është një panoramë e përgjithshme e kontrabandimit të migrantëve përmes Ballkanit Perëndimor. Ky informacion mbështetet në të dhënat e marra nga raporti ynë i vitit 2021 i titulluar "Çmimet në pikat kyçe: Analiza e flukseve të njerëzve, drogës dhe parave në Ballkanin Perëndimor".² Kjo vegël ofron të dhëna për kalimet e parregullta të kufirit përgjatë rrugës së Ballkanit, numrin dhe kombësinë e migrantëve dhe azil-kërkuesve, fitimet e përlllogaritura të tregut të kontrabandimit të migrantëve dhe një hartë

ndërvepruese ku shfaqen rrugët e kontrabandimit dhe çmimet që paguhen për secilën rrugë. Përdoreni këtë hapësirë për të parë në mënyrë grafike punën tonë, e cila përfshin edhe lidhjen midis krimit të organizuar dhe huliganizmit në futboll, si dhe trafikimin përmes portave të Evropës Juglindore.

Nëse dëshironi të sugjeroni ndonjë histori ose të bëni komente, jeni të lutur të na kontaktoni në adresën e emailit: almedina.dodic@globalinitiative.net

Shënime

1. Robin Cartwright dhe Kristina Amerhauser, Prurjet financiare të paligjshme në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi: Faktorët kryesorë dhe prirjet aktuale, GI-TOC, janar 2022. Për raportin e vitit 2020, shihni: Tuesday Reitano dhe Kristina Amerhauser, Prurjet financiare të paligjshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut: Faktorët kryesorë dhe prirjet aktuale, GI-TOC, gusht 2020, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/08/Prurje-Financiare-Te%CC%88-Paligjshme-Ne%CC%88-Shqipe%CC%88ri-Kosove%CC%88-Dhe-Maqedonine%CC%88-E-Veriut-Faktore%CC%88t-Kryesore%CC%88-Dhe-Prirjet-Aktuale.pdf>.
2. Walter Kemp, Kristina Amerhauser dhe Ruggero Scaturro, Çmimet në pikat kyçe: Analiza e flukseve të njerëzve, drogës dhe parave në Ballkanin Perëndimor, GI-TOC, maj 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/Hotspots3_PR_AL.docx.

1. A mund të ndikojë lufta në Ukrainë te krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor?

Teksa shohim të llahtaritur shkatërrimin e Ukrainës, krimi i organizuar nuk është gjëja më kryesore që na vjen në mendje. Por të gjitha luftërat kanë ndikime dhe pasoja të tërthorta afatgjata, siç kemi parë në rastin e Jugosllavisë në vitet 1990. Lufta në Ukrainë mund të shtojë mundësitë për krimin e organizuar në Ballkanin Perëndimor, si pasojë e trafikimit të armëve, pastrimit të parave, anashkalimit të sanksioneve, lëvizjes së luftëtarëve ose ndonjë ndryshimi të mundshëm të rrugëve të trafikimit.

Një prej reagimeve më mbresëlënëse të Perëndimit ndaj agresionit të Rusisë kundër Ukrainës ishte imponimi i kufizimeve ekonomike, duke përfshirë këtu sanksionet dhe ndalimin e udhëtimeve. Një prej pak rrugëve që rusët kanë në dispozicion për të udhëtuar është Beogradi. Nuk ka dyshim se edhe paratë e tyre mund të hyjnë në këtë rajon ose të lëvizin përmes tij. Në fakt,

gjatë viteve të fundit, me mijëra të huaj kanë përfituar nga ajo që quhet “skema e pasaportave të arta” në disa prej vendeve Evropiane, duke përfshirë Evropën Juglindore.¹ Dhe disa prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, si Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, vazhdojnë të ofrojnë skema për “shtetësinë në këmbim të investimit”.² Në një rast të kohëve të fundit, Mali i Zi i ofroi azil një oligarku rus i cili kërkohej për vrasje.³

Edhe pse nuk janë ndër investitorët më të mëdhenj në Ballkanin Perëndimor, në të kaluarën, oligarkët rusë dhe ukrainas e kanë “parkuar” pasurinë e tyre, për shembull, në Serbi ose përgjatë bregdetit malazez. Bregdeti Adriatik është fushë loje për ultra të pasurit. Një prej superjahteve të oligarkut rus, Roman Abramoviç, u ankorua kohëve të fundit në një port të vogël jahtesh të Malit të Zi.⁴



Refugjatët ukrainas kalojnë në Poloni, mars 2022.

Fotoja: Sean Gallup/Getty Images

Rusët e pasur në lëvizje mund të kërkojnë mundësi investimi në rajon dhe mund të shfrytëzojnë fare mirë edhe lidhjet me grupet kriminale jetëgjata që kanë kontakte me politikën dhe biznesin. Ekziston rreziku që paratë e rusëve mund të pastrohen në fusha si pasuria e paluajtshme, turizmi, lojrat e fatit dhe sektorë të tjerë që janë të cënueshëm ndaj PFP-ve, duke ndikuar në këtë mënyrë ekonominë dhe politikën vendore.

Rusia po përballë me sanksione pothuaj të pashoqe, dhe nëse konflikti vazhdon, numri i penaliteteve mund të rritet. Disa vende të Ballkanit Perëndimor nuk i janë bashkuar ndalimit të fluturimeve me Rusinë, prandaj aeroportet si ai i Beogradit (dhe përmes Stambollit, drejt të gjitha kryeqyteteve të vendeve të rajonit) janë bërë portalet kyçe për udhëtarët rusë. Ekziston mundësia që asetet e rusëve, të cilat janë ngrirë në shumë vende, mund të gjejnë një “parajsë të sigurt” në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku rusët ndihen si në shtëpinë e tyre për t’u marrë me veprimtari afariste. Ballkani Perëndimor mund të jetë edhe shteg për trafikimin e mallrave luksoze, alkoolit dhe cigareve. Por rajoni nuk kufizohet as me Ukrainën dhe as me Rusinë dhe niveli i anashkalimit të sanksioneve ndoshta do të jetë i kufizuar, por ia vlen që kjo dukuri të mbahet nën vërtetim.

Një shenjë frikësuese e kohëve që po jetojmë është se mund të krijohet një treg i zi për barnat që janë prodhuar për të ulur ndikimin ndaj rrezatimit bërthamor. Tani për tani, në farmacitë e Maqedonisë së Veriut nuk ka pothuaj fare pilula me jodur kaliumi.⁵ Sikurse ndodh në pjesë të tjera të Evropës, ekzistojnë shqetësime edhe për mungesa të komoditeteve te caktuara dhe për rritjen e çmimeve. Deri më tani, dy prej artikujve që kanë çmimin më të lartë në Ballkanin Perëndimor janë nafta dhe vaji i lulediellit.⁶ Tregjet ku mallrat janë të pakta mund të shërbejnë si nxitje për shfaqjen e kontrabandimit.

Ndryshimet e Rrugëve Të Trafikimit

Pasi Turqia i mbylli rrugët e trafikimit (sidomos të emigrantëve) pas vitit 2015, mendohet se disa rrugë të trafikimit të drogës kanë ndryshuar dhe se tani trafikimi bëhet përmes rrugëve detare nëpërmjet Detit të Zi, madje edhe drejt Adriatikut.⁷ Kjo prirje e fundit konfirmohet nga sekuestrimi i famshëm i 400 kilogramëve heroine nga Irani në portin e Varnës në Bullgari, dhe i 1 400 kilogramëve në Konstancë të Rumanisë nga autoritetet, përkatësisht në shkurt dhe maj të vitit 2021.⁸ Këto porte mund të bëhen më tërheqëse për prurjet e paligjshme nëse rrugët e trafikimit ndërpriten në Odesë dhe në portet e tjera të

Detit të Zi për shkak të luftës në Ukrainë. Rritja e trafikimit nëpërmjet rrugës Ballkanike detare mund të vihet re edhe nga sekuestrimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë viteve të fundit në portet e Adriatikut verilindor të Koperit në Slloveni (ku midis viteve 2019 dhe 2021 janë konfiskuar më shumë se një tonë heroinë), Ploçe të Kroacisë dhe Trieste të Italisë.⁹ Ky ndryshim i rrugëve të trafikimit të heroinës ndodh në një kohë kur ka prova të shumta se kokaina po trafikohet drejt porteve të Adriatikut. Edhe lumi i Danubit mund të bëhet rrugë trafikimi.

Në Ukrainë po derdhet një sasi e stërmadhe armësh, të cilat vijnë edhe nga Ballkani Perëndimor. Ka burime që tregojnë se pushkët automatike dhe mortajat e prodhuara në Serbi janë duke u përdorur në fushëbetje.¹⁰ Sipas një burimi që e njeh mjedisin kriminal të Bosnjës dhe Hercegovinës, çmimet e armëve të zjarrit në tregun e zi të këtij shteti janë rritur me më shumë se 100 për qind që prej fundit të shkurtit. Kjo prirje vihet re edhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor. Ekziston mundësia që lufta të ketë krijuar një rritje të kërkesës, edhe për shkak të atyre që shkojnë këtë rajon si luftëtarë vullnetarë. Ekziston rreziku që disa prej armëve që po përmbysin Ukrainën do të kthehen në Ballkanin Perëndimor për t’u përdorur nga grupet kriminale ose paramilitarë, ose për t’u shitur përsëri në tregun e zi.

Të rinjtë nga Evropa Juglindore kanë shkuar për të luftuar në Ukrainë—në të dy anët—që prej shpërthimit të krizës në vitin 2014,¹¹ edhe pse një veprim i tillë është i paligjshëm në shumicën e vendeve të rajonit. Me zgjatjen e luftës, pritët që ky numër të rritet, edhe për shkak se Ukraina ka krijuar të ashtuquajturin “legjion i huaj”.¹² Sikurse ndodh në raste të tjera, p.sh. si rasti i luftëtarëve që shkonin nga Evropa drejt Sirisë ose Irakut, shumë prej tyre nuk do të kthehen në atdhe.

Por lëvizja e armëve dhe luftëtarëve midis Ballkanit Perëndimor dhe Ukrainës mund të rrisë rrezikun për ekstremizëm të dhunshëm (sidomos të djathtë), vrasje dhe dhunë paramilitare. Ky kërcënim i fundit është shqetësues sidomos në lidhje me ndikimin destabilizues që kanë grupet e armatosura në rajonet ku tensionet etnike mund të rriten shpejt. Klubi i motoçiklistëve “Ujqit e Natës”, për shembull, ka degë në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Malin e Zi. Në të kaluarën, ka pasur raportime se në Serbi dhe në Republikën Serbe ka pasur mercenarë të trajnuar nga rusët, të cilët kishin lidhje me krimin e organizuar.¹³ Lëvizja e armëve dhe e luftëtarëve

drejt zonës së luftës në Ukrainë dhe prej saj mund të rrisë numrin e grupeve kriminale dhe paramilitare në Ballkanin Perëndimor, të fuqizojë arsenalin e tyre dhe të rrisë radikalizimin.

Numri i lartë i njerëzve—sidomos i grave dhe i fëmijëve—që po largohen nga Ukraina mund të rrisë ekspozimin ndaj trafikimit të qenieve njerëzore. Sa më shumë të zgjasë kjo krizë dhe sa më shumë të dëshpërohen njerëzit, aq më shumë do të rritet rreziku që disa njerëz të bëhen viktimë të shfrytëzimit seksual edhe në Ballkanin Perëndimor, për shembull në qytetet e mëdha, në resortet në linjën bregdetare të Adriatikut ose në internet. Në fakt, Europoli ka lëshuar një njoftim për paralajmërim të hershëm, në të cilin vë në dukje mënyrën se si gratë, fëmijët dhe personat e cenueshëm janë viktimë të mundshme të rrjeteve kriminale që merren me trafikimin e qenieve njerëzore.¹⁴ Europoli ka paralajmëruar se të miturit e pashoqëruar janë më të ekspozuarit ndaj rrezikut të shfrytëzimit seksual dhe për qëllime pune si dhe për kriminalitet të detyruar dhe lypje ose për veprimtari të tjera.

Shënime

1. Clara Hernanz Lizarraga, Russia's war puts Europe's 'golden passports' under microscope [Lufta e Rusisë vë nën mikroskop "pasaportat e arta"], Bloomberg, 15 mars 2022, <https://www.bloomberg.com/news/articles/2022-03-15/russia-s-war-puts-europe-s-golden-passports-under-microscope>.
2. Samir Kajosevic, Montenegro extends 'golden passport' program despite EU criticism [Mali i Zi zgjat programin e "pasaportave të arta" pavarësisht kritikave të BE-së], BalkanInsight, 31 dhjetor 2021, <https://balkaninsight.com/2021/12/31/montenegro-extends-golden-passport-program-despite-eu-criticism/>.
3. Montenegro grants asylum to tycoon wanted in Russia for murder [Mali i Zi i jep azil manjatis që kërkohet në Rusi për vrasje], The Moscow Times, 23 tetor 2021, <https://www.themoscowtimes.com/2021/10/23/montenegro-grants-asylum-to-tycoon-wanted-in-russia-for-murder-a75381>.
4. Abramovich's superyacht cruises in to Montenegro marina [Superjahti i Abramoviçit ankorohet në portin e jahteve të Malit të Zi], France24, 12 mars 2022, <https://www.france24.com/en/live-news/20220312-abramovich-s-superyacht-cruises-in-to-montenegro-marina>.
5. Срѓан Стојанчов, За пандемијата се бараше тоалетна, за нуклеарната закана јод, Радио Слободна Европа, 3 mars 2022, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/за-пандемијата-се-бараше-тоалетна-за-нуклеарната-закана-јод-/31734027.html>.
6. N1, Zašto je poskupilo domaće suncokretovo ulje – 4,85 KM po litru?, 15 mars 2022, <https://ba.n1info.com/vijesti/zasto-je-poskupilo-domace-suncokretovo-ulje-485-km-po-litru>.
7. Ben Crabtree, Black Sea: A rising tide of illicit business? [Deti i Zi: A po ngrihet vala e biznesit të paligjshëm?], GI-TOC, 1 prill 2020, <https://globalinitiative.net/analysis/black-sea-illicit-flows/>.
8. Bulgarian prosecutors say heroin found in cargo from Iran [Prokurorët bullgarë thonë se kanë gjetur heroinë në mallrat që vinin nga Irani], ABC News, 16 shkurt 2021,

Lufta në Ukrainë ka krijuar trazirën më të madhe në sigurinë Evropiane që prej fundit të Luftës së Ftohtë dhe tronditjen më të thellë të rendit botëror që prej vitit 1945. Kriminelët janë gjithmonë ata që bëjnë lëvizjen e parë kur ndodhin ndryshime dhe kur ka konflikte. Nuk ka dyshim se lufta do të ketë ndikim në gjeopolitikën e Ballkanit Perëndimor dhe ndoshta edhe në politikën kombëtare dhe marrëdhëniet ndëretnike. Ajo mund të ringjallë diskutimet për procesin e anëtarësimit në BE, sidomos duke marrë parasysh aplikimin e Ukrainës për t'u anëtarësuar në BE.¹⁵

Por lufta mund të ketë ndikim edhe te tregjet kriminale dhe PFP-të. Ajo ka nxitur largimin e të rinjve drejt fushëbetejës së re të Evropës. Kjo është diçka që agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit, organizatat rajonale dhe të gjitha palët e interesuara për qëndrueshmëri në Ballkanin Perëndimor, duhet të parashikojnë dhe monitorojnë situatën nga afër, sidomos pasi këta luftëtarë dhe armët e tyre të kthehen në atdhe. Për sa i takon GI-TOC-së, ne do të vazhdojmë të monitorojmë ndikimin e luftës në tregjet kriminale.

- <https://abcnews.go.com/International/wireStory/bulgarian-prosecutors-heroin-found-cargo-iran-75923810>; 'Historical seizure' of heroin at Romanian Black Sea port ["Sekuestrim historik" i heroinës në portin e Rumanisë në Detin e Zi], AP News, 20 maj 2021, <https://apnews.com/article/black-sea-europe-romania-business-government-and-politics-a048a5d3cb5ad48f20067c3d11edc58e>.
9. I. Hina, Slovenska policija u Kopru otkrila 730 kilograma iranskog heroína, T Portal, 13 nëntor 2019, <https://www.tportal.hr/vijesti/clanak/slovenska-policija-u-kopru-otkrila-730-kilograma-iranskog-heroína-20191113>; R K, V Luki Koper zasegli več kot 200 kilogramov heroína; Siol, 16 qershor 2021, <https://siol.net/novice/slovenija/v-luki-koper-zasegli-vec-kot-200-kilogramov-heroína-554783>; Maxi sequestro di eroina al porto, i cani fiutano un carico da 50 chili, Trieste Prima, 20 korrik 2018, <https://www.triesteprema.it/cronaca/maxi-sequestro-eroina-porto-trieste.html>; Hina, Croatian police seize 220 kg of heroin and 62 kg of cocaine in the port of Ploče [Hinë, Policia kroate sekuestron 220 kg heroinë dhe 62 kg kokainë në portin e Plocës], N1, 11 janar 2022, <https://hr.n1info.com/english/news/croatian-police-seize-220-kg-of-heroin-and-62-kg-of-cocaine-in-the-port-of-ploce/>.
10. Aleksandar Radić, Oružje iz ex YU na ukrajinskom ratištu, Balkanska bezbednosna mreža, 15 mars 2022, <https://www.balkansec.net/post/oru%C5%BEje-iz-ex-yu-na-ukrajinskom-rati%C5%A1tu>; Vuk Cvijić, Srpske mine na ukrajinskom frontu, NIN, 31 mars 2022, <https://www.nin.co.rs/pages/article.php?id=102361781>; Battle of Kyiv [Beteja e Kievit]. Moshchun. Hostomel, Direction Ukrainian military TV, 13 mars 2022, <https://youtu.be/NdZVNU93Bvs>.

11. Mila Đurđević, Dobrovoljci iz Srbije u Ukrajini: Politička i vojna smetnja, Radio Slobodna Evropa, 24 shkurt 2022, <https://www.slobodnaevropa.org/a/srbija-ukrajina-borci/31718923.html>.
12. Rusko ministarstvo: 'U Ukrajini je 200 hrvatskih plaćenika'. Tvrdi da ih je organizirao Hrvat koji je šest godina ratovao u pukovniji Azov, Slobodna Dalmacija, 3 mars 2022, <https://slobodnadalmacija.hr/vijesti/svijet/rusko-ministarstvo-u-ukrajini-je-200-hrvatskih-placenika-tvrde-da-ih-je-organizirao-hrvat-koji-je-sest-godina-ratovao-u-pukovniji-azov-1172456>.
13. Julian Borger, Russian-trained mercenaries back Bosnia's Serb separatists [Mercenarët e trajnuar nga rusët mbështesin separatistët serb të Bosnjës], The Guardian, 12 janar 2018, <https://www.theguardian.com/world/2018/jan/12/russian-trained-mercenaries-back-bosnias-serb-separatists>.
14. European Migrant Smuggling Centre, War in Ukraine – refugees arriving to the EU from Ukraine at risk of exploitation as part of THB, Europol [Qendra Evropiane për Kontrabandimin e Migrantëve, Lufta në Ukrainë – refugjatët që vijnë në BE nga Ukraina rrezikojnë të shfrytëzohen në kuadër të trafikimit të qenieve njerëzore], mars 2022, https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/Early_Warning_Notification__War_in_Ukraine_-_refugees_arriving_to_the_EU_from_Ukraine_at_risk_of_exploitation_as_part_of_THB.pdf.
15. Erwan Fouéré, Can the war in Ukraine revive the EU's enlargement agenda for the Western Balkans? [A mund të ringjallë lufta në Ukrainë agjendën e zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor?], CEPS Policy Insights, nr. 2022-11, 24 mars 2022, https://www.ceps.eu/download/publication/?id=35980&pdf=PI2022-11_Can-the-war-in-Ukraine-revive-the-EUs-enlargement.pdf.

2. Bosnja dhe Hercegovina është bërë qyteti kyç i tranzitit për trafikimin e armëve në Evropë.

Prej shumë kohës, Bosnja dhe Hercegovina kanë qenë vend origjine për kontrabandimin e armëve. Që prej fundit të luftës së Bosnjës në vitin 1995, vendi ka pasur një numër të madh armësh të vogla dhe të lehta. Edhe pse disa prej këtyre armëve janë trafikuar drejt zonave të konfliktit në rajon, të tjerat janë përdorur për sulme terroriste në Evropën Perëndimore. Pas fillimit të luftës në Ukrainë, çmimet e armëve në tregun e zi kanë arritur majat. Nga operacionet e fundit policore vihet re se tregtia është e organizuar mirë edhe në nivel ndërkombëtar dhe se Bosnja dhe Hercegovina tani është edhe vend tranziti për kontrabandimin e armëve.

Arsenali në të shkuarën dhe në të tashmen

Bosnja dhe Hercegovina ka një popullsi prej rreth 3,2 milionë banorësh. Në vitin 2010, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara vlerësoi se në këtë vend kishte rreth 750 000 armë në posedim të paligjshëm.¹ Mbështetur në të dhënat e vendndodhjes së aksioneve policore ku janë gjetur armë ose ku janë arrestuar kriminelë, është e dukshme se armët e paligjshme të zjarrit gjenden pothuaj në çdo pjesë të Bosnjës, por kryesisht në lindje të vendit dhe në rajonet e Tuzlës dhe Sarajevës, Hercegovinës perëndimore, zonës së Bosanska Gradishkës, Banja Lukës, Teshanjit, Dobojit, Bijelinës dhe Zenicës.

Më tej, përllogaritet se që prej vitit 2006, ka pasur nëntë vjedhje armësh nga depot e forcave të armatosura të Bosnjës. Në shkurt të vitit 2017, tetë pistoleta dhe gjashtë pistoleta automatike u zhdukën nga kazermat në Bilecë,² ndërsa në vitin 2018, një ushtar vodhi armë dhe municione në kazermat e Pales.³ Në shkurt të vitit 2021, Ministria e Mbrojtjes deklaroi se “një sasi e caktuar armësh është zhdukur” nga qendra e stërvitjes bazë në Pazariç dhe se vula e sigurisë në hyrjen e depos së armëve dhe pajisjeve ushtarake ishte dëmtuar.⁴ Zëvendës kryetarja e komisionit të përbashkët parlamentar për mbrojtjen dhe sigurinë, Dushanka Majkić (Dušanka Majkić), pyeti se si ishte e mundur që 25 pistoleta tepër cilësore të zhdukeshin nga ambientet e ministrisë dhe si ishte e mundur që dikush mund të hyjë në depo dhe të dijë me saktësi se ku të shkojë dhe çfarë të marrë.⁵ Ia vlen të përmendim se shumë prej

këtyre rasteve nuk u zgjidhën kurrë. Sipas Majkićit, “armët zakonisht përfundojnë në tregje të huaja... është çështje e tregtisë të mirë, të shpejtë e të lehtë.”⁶

Sipas informacioneve të Policisë Kufitare të Bosnjës dhe Hercegovinës, një numër sekuestrimesh të bëra kohëve të fundit tregojnë se kontrabandimi i armëve të zjarrit nga Bosnja dhe Hercegovina është shumë aktiv. Në vitin 2021, policia në Bosnjë dhe Hercegovinë regjistroi 18 krime të ndërlidhura me kontrabandimin e armëve. U konfiskuan 27 armë, një bombë dhe 1 135 municione. Gjatë së njëjtës periudhë, kundër kontrabandistëve të dyshuar u parashtruan shtatë akuza për kundërvajtje, ndërsa dy armë dhe 231 municione u konfiskuan përkohësisht.⁷

Droga dhe armët kalojnë nëpër të njëjtat rrugë

Grupet e krimit të organizuar që kontrabandojnë armë shpesh merren edhe me kontrabandimin e drogave. Rrugët me të përdorura janë ato që ndodhen në vatra të nxehta të mirënjohura të krimit të organizuar, për shembull, autostradat kryesore dhe pikëkalimet kufitare. Mjetet që përdoren janë kamionët. Megjithatë, ndonjëherë përdoret edhe terreni që është më i vështirë për t'u kaluar, për shembull rrugët e pyllit përgjatë kufirit midis Malit të Zi⁸ dhe rajoneve të Trebinjës⁹ dhe Bilecës të Bosnjës dhe Hercegovinës, duke përdorur varka dhe gomone në rajonin e Bijelinës në Serbi ose në Rrethin e Bërçkos në Bosnjë dhe Hercegovinë,¹⁰ ose rrugët nëpër pyll përreth Kaplinës, Lubuskit ose Grudes në Kroaci.¹¹ Sipas një anëtarit të dënuar të një grupi të krimit të organizuar nga Trebinja, kur trafikantët e armëve i përdorin këto rrugë, ata punësojnë udhërrëfyes dhe hamallë vendas.

Ka edhe raportime që thonë se armët që vijnë nga vende të tjera të Ballkanit Perëndimor trafikohen përmes Bosnjës dhe Hercegovinës. Një avokat që ka mbrojtur të dyshuarit për trafikim armësh para gjykatave boshnjake gjatë 15 viteve të fundit tha: “Ekziston një kanal kontrabandimi që kalon nga Shqipëria dhe Mali i Zi, në Hercegovinën lindore dhe perëndimore, Kroaci dhe Evropë, dhe këtë kontrabandim e bëjnë kroatët dhe serbët. Mendoj se ky është kanali më i fuqishëm që kalon pak a shumë nga Mali i Zi përmes këtyre kalimeve “të egra” në Bilecë dhe në zonën rrethuese. Ai kalon



Figura 1 Kontrabandimi i armëve përmes Bosnjës dhe Hercegovinës.

përmes Hercegovinës lindore, ku ekipi tjetër merr përsipër transportin për në Kroaci.”¹²

Në raste të tjera, armët janë destinuar për Evropën Perëndimore. Në mars të vitit 2022, një hetim ndërkombëtar i përbashkët midis policisë franceze dhe kroate zbuloi se një grup kriminal që përbëhej nga anëtarë nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Franca po përpiqeshin të kontrabandonin armë drejt Francës.¹³

Në dhjetor të vitit 2018, Zyra Kroate për Shtypjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nisi një hetim kundër dy anëtarëve kroatë të një organizate kriminale, të cilët pretendohet se kishin kontrabanduar ekstazi nga Holanda drejt Kroacisë, si dhe pajisje optike për armët dhe 37 kilogramë eksplozivë plastikë nga Bosnja dhe Hercegovina drejt Kroacisë.

Plani i grupit kriminal ishte të blinte në Holandë një sasi të madhe ekstazie dhe kokaine, ta kontrabandonte atë në Kroaci dhe t’ua shiste blerësve me të cilët ishin marrë vesh më përpara, dhe të kontrabandonin dhe të shisnin sasi të mëdha armësh nga Bosnja dhe Hercegovina drejt Kroacisë dhe pastaj drejt vendeve të Evropës Perëndimore. Policia ka konfiskuar armë dhe eksplozivë në zonën e Slavonski Brodit dhe Okučanit.¹⁴

Lidhet midis armëve dhe trafikimit të drogës mund të shihen edhe në operacionin policor të dhjetorit të vitit 2021, të quajtur “Depoja 2”,¹⁵ i cili u realizua në qytetin e Bosanska Gradiskës në Republikën Serbe, pranë kufirit me Kroacinë. Operacioni u krye për të shkatërruar një rreth trafikimi droge, por pas kërkimeve në disa vendndodhje, policia zbuloi sasi të mëdha armësh, municioni dhe minash. U arrestuan njëzet anëtarë të dyshuar të një grupi krimi të organizuar.

Sipas raporteve të medias, policia e kishte monitoruar grupin nga Bosanska Gradiska nëpërmjet aplikacionit “Sky” (shqipto: skaj).¹⁶ Ata kishin vërtetuar se droga dhe armët e zjarrit ishin ruajtur përkohësisht në vende të fshehura në Bosanska Gradiskë dhe që grupi kishte furgonë dhe mjete pasagjerësh me dhomëza të posaçme për të fshehur lëndët narkotike dhe armët. Sipas dokumenteve të prokurorisë, grupi kishte lidhje me bashkëfajtorë në Zagreb dhe Osijek të Kroacisë dhe me klientë në Serbi dhe Evropën Perëndimore.¹⁷ Për shembull, në nëntor të vitit 2020, anëtarët e grupit pretendohet se trafikuan 23 pistoleta nga Bosnja dhe Hercegovina drejt Gjermanisë, duke fituar kështu 53 000 euro.



Armët e konfiskuara nga shtëpia e një kriminelit dhe vrasësi të dyshuar në Ritopek të Serbisë.

Fotoja: Ministria e Brendshme e Serbisë

la vlen të përmendim këtu se anëtarët e grupit kriminal nga Bosanska Gradiska kanë pasur gisht në një numër ekzekutimesh në Serbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë. Për shembull, ndërsa kërkonte për vrasësin e Strahinja Stojanoviçit (Strahinja Stojanović), i cili u vra më 13 shtator 2020 në një atentat me bombë në makinë, policia serbe zbuloi “shtëpinë e llahtarisë” në Ritopek, i cili mendohet se është vendlindja e vrasësit. Ajo ishte e mbushur me armë, disa prej të cilave pretendohet se ishin blerë nga kriminelët në Bosanska Gradiskë.¹⁸

Shitjet e drejtpërdrejta

Ndonëse grupet kriminale nga Bosnja dhe Hercegovina duket se janë pjesë e rrjeteve kriminale shumëkombëshe, në raste të tjera ato duket se mundohen të shesin armë “vetë”, për të pasur fitime më të mëdha. Në janar të vitit 2020, policia gjermane dhe ajo boshnjake pengoi një përpjekje të një qytetari boshnjak për të kontrabanduar armë drejt Gjermanisë dhe Holandës. Sipas një aktakuze të Prokurorisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, në Dresden, në një automjet me targa boshnjake, u gjetën 95 granata dore, katër armë gjysmë-automatike, tetë pistoletat dhe një sasi e konsiderueshme municioni armësh me kalibra të ndryshëm. Të gjitha këto ishin destinuar për tregun e paligjshëm.¹⁹ Po ashtu, në maj të vitit 2021, policia e Bosnjës dhe Hercegovinës arrestoi

katër veta që po përpiqeshin të kontrabandonin sasi të mëdha armësh zjarri të paligjshme (duke përfshirë edhe raketahedhës dore) drejt Evropës Perëndimore.²⁰ Tre prej tyre ishin dënuar më përpara për krime të ngjashme. Në gusht të vitit 2021, efektivet e policisë kufitare boshnjake konfiskuan një arsenal armësh dhe municioni dhe arrestuan një qytetar boshnjak nga Zvorniku, i cili dyshohej për kontrabandim armësh drejt Francës për tregun e paligjshëm.²¹

Sipas një ish-anëtari të grupit kriminal nga Trebinja, kërkesa për armë dhe kostoja e tyre në rajon rritet gjatë periudhave të paqëndrueshmërisë politike, siç ishte rasti i ngritjes së barrikadave në veri të Kosovës ose përpara zgjedhjeve të vitit 2020 në Mal të Zi.²² Ekziston raporte sipas të cilave çmimet për armët e zjarrit në tregun e zi në Bosnjë dhe Hercegovinë janë dyfishuar që prej fillimit të luftës në Ukrainë.

Trafikimi i armëve të vogla dhe të lehta është në vetvete kërcënim dhe shpesh efekt anësor i konflikteve. Sikurse është treguar në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, grupet kriminale të përfshira në trafikimin e drogës shpesh merren edhe me trafikimin e armëve, për të cilat Ballkani Perëndimor vazhdon të mbetet rajon kryesor furnizimi dhe tranziti.

Shënime

1. A Đugum dhe M Žuvela, Ukradenom oružju iz kasarni BiH se redovno ne ulazi u trag, Radio Slobodna Evropa, 15 shkurt 2021, <https://www.slobodnaevropa.org/a/ukradenom-oružju-iz-kasarni-u-bih-se-redovno-ne-ulazi-u-trag/31104191.html>.
2. N N, Novi skandal u Oružanim snagama BiH: Iz kasarne u Bileći nestalo oružje, Nezavisne novine, 7 mars 2017, <https://www.nezavisne.com/novosti/bih/Novi-skandal-u-Oružnim-snagama-BiH-Iz-kasarne-u-Bileći-nestalo-oružje/416228>.
3. B Brezo, Misteriozna krađa u kasarnama u BiH: Gdje završava ukradeno oružje?, N1 BiH, 17 shkurt 2021, <https://ba.n1info.com/vijesti/kradja-oruzja-u-kasarnama-u-bih-ko-kako-i-gdje-je-zavrсило/>.
4. Potvrđeno: Nestalo oružje u Pazariću, istraga u toku, N1 BiH, 12 shkurt 2021, <https://ba.n1info.com/vijesti/potvrđeno-nestalo-oružje-u-pazaricu-istraga-u-toku/>.
5. Majkić: Nestanak oružja iz kasarne novi sigurnosni izazov za BiH, Klix, 16 shkurt 2021, <https://www.klix.ba/vijesti/bih/majkić-nestanak-oruzja-iz-kasarne-novi-sigurnosni-izazov-za-bih/210216076>.
6. A Đugum dhe M Žuvela, Ukradenom oružju iz kasarni BiH se redovno ne ulazi u trag, Radio Slobodna Evropa, 15 shkurt 2021, <https://www.slobodnaevropa.org/a/ukradenom-oružju-iz-kasarni-u-bih-se-redovno-ne-ulazi-u-trag/31104191.html>.
7. Intervistë me drejtuesin e hetimeve në Policinë Kufitare të Bosnjës dhe Hercegovinës, 15 janar 2022, Sarajevë.
8. J Jovanović, Procurili dokazi; šta će sada izmisliti Čovićev direktor Granične policije: Na ovom mjestu je granica BiH šuplja kao sir..., Slobodna Bosna, 6 nëntor 2019, https://www.slobodna-bosna.ba/vijest/132351/procurili_dokazi_sta_će_sada_izmisliti_čovićev_direktor_granične_policije_na_ovom_mjestu_je_granica_bih_šuplja_kao_sir.html.
9. A Terzić, Otvorena južna ruta: Sve više migranata preko Trebinja do Zapada, Anadoly Agency, 22 dhjetor 2017, <https://www.aa.com.tr/ba/balkan/otvorena-južna-ruta-sve-više-migranata-preko-trebinja-do-zapada/1012210>.
10. Akcija policije BiH i Hrvatske na Savi, hapšenja zbog krijumčarenja migranata, N1 BiH, 22 shtator 2021, <https://ba.n1info.com/vijesti/akcija-policije-bih-i-hrvatske-na-savi-hapsenja-zbog-krijumčarenja-migranata/>.
11. N N, Osuđen bračni par iz Trebinja zbog šverca heroína iz BiH u Hrvatsku, Nezavisne novine, 10 korrik 2019, <https://www.nezavisne.com/novosti/hronika/Osudjen-bracni-par-iz-Trebinja-zbog-sverca-heroína-iz-BiH-u-Hrvatsku/547591>.
12. M Sadiković and Dž Halimović, Ilegalna trgovina oružjem iz BiH ka Evropi, Radio Slobodne Evrope, 30 prill 2021, <https://www.slobodnaevropa.org/a/ilegalna-trgovina-oruzjem-u-bosni-i-hercegovini/31229561.html>.

13. Ahmet Kalajdžić, Zbog krijumčarenja oružja Francuzima po pet, a švicarskom gastarbajteru tri mjeseca zatvora, Dubrovački Vjesnik, 5 mars 2022, <https://dubrovacki.slobodnadalmacija.hr/dubrovnik/vijesti/crna-kronika/zbog-krijumcarenja-oruzja-francuzima-po-pet-a-svicarskom-gastarbajteru-tri-mjeseca-zatvor-1173033-dhe-Zajednickom-akcijom-hrvatske-i-francuske-policije-razotkriveno-krijumcarenje-oruzja-namijenjenog-Francuskoj,-Republika-Hrvatska-Policijska-uprava-dubrovačko-neretvanska,-30-mars-2022,-https://dubrovacko-neretvanska-policija.gov.hr/novosti/zajednickom-akcijom-hrvatske-i-francuske-policije-razotkriveno-krijumcarenje-oruzja-namijenjenog-francuskoj/14320>.
14. USKOK – Hrvatski državljani uhapšeni zbog krijumčarenja oružja i eksploziva iz BiH, Radio Sarajevo, 19 dhjetor 2018, <https://radiosarajevo.ba/vijesti/bosna-i-hercegovina/hrvatski-drzavljanu-uhapseni-zbog-krijumcarenja-oruzja-i-eksploziva-iz-bih/321802>.
15. G Obradović, Ekskluzivni detalji akcije „Storidž 2“ Kriminalci iz Gradiške prodavali oružje Velji Nevolji, do njih odveli dokazi iz kuće strave, Srpskainfo, 10 dhjetor 2021, <https://srpskainfo.com/ekskluzivni-detallji-akcije-storidz-2-kriminalci-iz-gradiske-prodavali-oruzje-velji-nevolji-do-njih-odveli-dokazi-iz-kuce-strave/>.
16. M Aščić, Kako je aplikacija „Sky“ raskrinkala opasnu narkobandu iz Bosanske Gradiške: Na prodaji pištolja zaradili 100.000 KM!, Avaz, 6 janar 2022, <https://avaz.ba/vijesti/bih/708294/kako-je-aplikacija-sky-raskrinkala-opasnu-narkobandu-iz-bosanske-gradiske-na-prodaji-pistolja-zaradili-100-000-km>.
17. Po aty.
18. G Obradović, Ekskluzivni detalji policijske akcije „Storidž 2“ Kriminalci iz Gradiške prodavali oružje Velji Nevolji, do njih odveli dokazi iz kuće strave u Ritopeku, Blic, 10 dhjetor 2021, <https://www.blic.rs/vesti/republika-srpska/ekskluzivni-detallji-policijske-akcije-storidz-2-kriminalci-iz-gradiske-prodavali/OhgvleB>.
19. Podignuta optužnica protiv dvije osobe optužene za međunarodno krijumčarenje oružja i vojne opreme, Tužilaštvo Bosne i Hercegovine, 17 janar 2020, <http://www.tuzilastvobih.gov.ba/index.php?id=4397&jezik=b>.
20. Podignuta optužnica protiv četiri osobe optužene za međunarodno krijumčarenje oružja i vojne opreme, Tužilaštvo Bosne i Hercegovine, 7 maj 2021, <http://www.tuzilastvobih.gov.ba/index.php?id=4885&jezik=b>.
21. Otkriven lanac švercera oružja iz BiH u Francusku, uhićen čovjek iz Zvornika, Index, 7 gusht 2021, <https://www.index.hr/vijesti/clanak/otkriven-lanac-svercera-oruzja-iz-bih-u-francusku-uhicen-covjek-iz-zvornika/2295755.aspx>.
22. Intervistë me një kriminel të dënuar nga Trebinja, i cili ka qenë i përfshirë në rishitjen e armëve dhe i nje kontrabandistët, rrugët e kontrabandimit dhe çmimet për kontrabandimin. Trebinje, 7 janar 2022.

3. Bërçkoja: Treg për krimin e organizuar.

Gjatë viteve të fundit, Rrethi i Bërçkos në Bosnjë dhe Hercegovinë është bërë skenë e një numri incidentesh që ka të bëjë me kontrabandimin e migrantëve, armëve dhe drogës. Kjo ndodh pjesërisht për shkak se Bërçkoja ndodhet përgjatë rrugëve të trafikimit dhe për shkak të qeverisjes së dobët dhe korrupsionit.

Përpara se të shpërthente lufta e vitit 1992 në Bosnjë dhe Hercegovinë, Bërçkoja ishte një qytet shumetnik dhe pikë transportimi e mirënjohur rajonale ku takoheshin hekurudha kryesore, rrugët tokësore dhe ato ujore, duke lidhur kështu gjithë Jugosllavinë. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, Bërçkoja tani ndodhet në një trekëndësh ku takohen kufijtë e Kroacisë, Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Porti i Bërçkos dikur ishte një prej porteve më të rëndësishëm lumorë në ish-Jugosllavi. Ky pozicion strategjik ishte arsyeja pse Bërçkoja pësoi shkatërrim kolosal gjatë luftës. Si pasojë e luftimeve të mëdha, qyteti u shkatërrua dhe popullsia kroate dhe boshnjake u dëbua. Statusi i Bërçkos u kontestua aq shumë, sa që gjatë bisedimeve për paqen në Dejton u vendos që qyteti, jo vetëm që do të ishte pjesë e Bosnjës dhe Hercegovinës, por do të merrte statusin e një entiteti të veçantë të përzierë i cili u njoh zyrtarisht si rreth.

Gjatë luftës, Bërçkoja u bë portali i veprimtarive të tregut të zi. Pas luftës, paqeruajtësit pastruan një zonë dhe, pa kaluar shumë kohë, tregtarët filluan të konfigurorin ndërtesa të improvizuar për të shitur mallrat e tyre. I ashtuquajtur "tregu i Arizonës" u bë një pazar famëkeq pa taksë ku ishte e mundur të blije pothuaj gjithçka. Për pasojë, ai u bë magnet që tërhoqi kontrabandën dhe llojet e tjera të krimit, duke përfshirë edhe prostitucionin.¹ Përlllogaritet se në vitin 1996, tregu i zi përbënte 98 për qind të ekonomisë së rrethit.

Për të vënë nën kontroll tregtinë, qeveria lokale dhe partnerët e saj ndërkombëtarë ndërtuan një treg të ri, i cili u bë vendi ku njerëzit, nga i gjithë rajoni, mund të blejnë dhe shesin mallra. Sot, ky treg përbëhet nga më shumë se 2 000 njësi biznesi. Përlllogaritet se tregun e vizitojnë çdo ditë 5 000 deri në 6 000 vetë.² Rreth 10 milionë euro taksa derdhen çdo vit në buxhetin e shtetit nga të ardhurat e tregut të Arizonës, i cili është bërë tregu më i madh në ish-Jugosllavi.³ Megjithatë, Bërçkoja vazhdon të mbetet një prej rajoneve më të varfra në vend. Në dhjetor të vitit 2021, rroga mesatare mujore ishte 502 euro, më e ulëta në Bosnjë dhe Hercegovinë.⁴

Por shndërrimi i tregut të zi për mallra të ligjshme në treg të ligjshëm nuk i eliminoi veprimtaritë e paligjshme në rreth. Kriminelët kërkuar mundësi të tjera, sidomos për të trafikuar drogë dhe qenie njerëzore dhe për të kontrabanduar armë zjarri dhe mallra me tarifa të larta.

Bashkëpunimi në radhët e kriminelëve, korrupsioni në radhët e policisë

Gjeografia e Bërçkos e bën këtë rreth një kyçe të kontrabandimit midis Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Serbisë. Ai ndodhet në anën tjetër të lumit Sava që ndan vendin me Evropën. Kjo e bën atë magnet për kontrabandimin jashtë rajonit, duke përfshirë këtu edhe kontrabandimin e migrantëve. Grupet kriminale në Bërçko merren me veprimtari kriminale ndërkombëtare me homologët e tyre në dy vendet fqinje. Gjatë dy viteve të fundit, disa operacione policore kanë prishur kontrabandimin e drogës, armëve të zjarrit dhe migrantëve nga ana e grupeve kriminale shumëkombëshe.⁵ Dihet se ndonjëherë kriminelët nga Kroacia dhe Serbia e kapërcejnë kufirin dhe shkojnë në Bërçko ku nuk ndihen.⁶ Me këtë nuk duam të themi që Bërçkoja është vend ku ka paqe të përhershme. Për shkak të mjedisit kriminal, ka ndodhur një numër incidentesh të dhunshme, si në aspektin e larjes së hesapeve midis grupeve kriminale, ashtu edhe të grabitjeve me armë dhe sulmeve.⁷

Edhe pse kriminelët lëvizin nëpër rajon relativisht lehtë, sistemi kompleks i qeverisë së Bosnjës—i cili pasqyrohet edhe në polici dhe sistemin gjyqësor—ndonjëherë pengon bashkëpunimin midis zyrtarëve të agjencive të zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi i dobët midis agjencive të kantoneve, atyre federale dhe agjencive shtetërore në aksione të përbashkëta në drejtim të luftës kundër krimit, për të mos përmendur këtu mungesën e shkëmbimit të të dhënave, u jep kriminelëve hapësirë për të vepruar.

Edhe korrupsioni e pengon luftën kundër krimit të organizuar. Grupet kriminale kanë arritur të rekrutojnë efektivë të policisë nga Bërçkoja për të marrë pjesë personalisht në trafikimin dhe kontrabandimin e drogës dhe për të mbrojtur dhe ndërmjetësuar në dorëzimin e drogës. Në vitin 2018, asistent shefi i policisë penale të Rrethit të Bërçkos u arrestua pasi në makinë iu gjetën 1,1 kilogramë kokainë e pastër me vlerë 130 000 euro.⁸ Meqë parregullsitë vazhduan, në prill të vitit 2019, shefi




Figura 2 Bërrçoja, në Bosnjë dhe Hercegovinë, është një kyçe e kontrabandimit në rajon.

i policisë pezulloi përkohësisht shtatë efektivë policie për shkak të dyshimeve se kishin bërë shkelje të rënda të detyrës zyrtare.⁹ Pak kohë pas kësaj, efektivët e policisë u arrestuan përsëri në zonën e Rrethit të Bërrços, bashkë me efektivë të policisë kufitare, për shkak të veprave penale të rryshfetit dhe kontrabandimit të migrantëve dhe drogës. Ajo që të habit këtu është që ka shumë raste korrupsioni në një zonë aq të vogël, pavarësisht faktit që policia paguhet më mirë se në pjesët e tjera të Bosnjës dhe Hercegovinës, ka pajisje më të mira, trajnohet dhe merr mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar dhe punon në një ndërtesë të re që kushton më shumë se 5 milionë euro.¹⁰

Pavarësisht problemeve me krimin e organizuar në rajon dhe me korrupsionin brenda shërbimit policor, policia e Bërrços ka kryer disa operacione të suksesshme kundër kontrabandimit të migrantëve, armëve dhe drogës, sidomos në bashkëpunim me homologët e saj në Kroaci, Gjermani dhe Austri.

Në operacionin policor të koduar me emrin “Cer”, të realizuar në vitin 2019, 17 veta u arrestuan, duke përfshirë edhe dy ish-efektivë policie dhe një efektiv policie që ishte ende në detyrë. U gjet një sasi e madhe lëndësh narkotike e destinuar për shitje në rrugë dhe u konfiskuan rreth 3 kilogramë drogë. Këtu përfshihen marihuana, metamfetaminë dhe ekstazi, në vlerën 20 000 euro si dhe aksesore ambalazhimi, armë dhe telefona celularë. U konfiskuan mbi 8 000 euro në monedhë vendase.¹¹

Gjatë një aksioni policor të koduar “Bjegunac”, i realizuar në nëntor të vitit 2021, dy anëtarë të policisë së Bërrços ishin pjesë e një grupi të organizuar kriminal që merrej me blerje dhe shitje droge në Rrethin e Bërrços dhe në zonën e Bijelinës, Pelagiçevës dhe Orashjes. Gjatë këtij operacioni, u gjet rreth një kilogramë marihuanë dhe pak më shumë se një qind gramë kokainë.¹²

Bërrçoja ka shumë prej karakteristikave që vihen re në vatrat e tjera të nxehta të krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor: një vend tërheqës për trafikimin,

qeverisje të dobët (në këtë rast, të përkeqësuar nga korrupsioni) dhe dobësi ekonomike. Ai vuan edhe nga handikapi i keqpërdorimit të fondeve që nevojiten aq shumë për të forcuar aftësinë e shoqërisë civile për t'i bërë ballë krimit të organizuar. Në këtë vend kaq të vogël, të gjithë e njohin njëri-tjetrin. Kjo e bën ndryshimin të vështirë. Nga ana tjetër, qasja e dedikuar e zyrtarëve të ndershëm, e përforcuar me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar, mund të sjellë ndryshime të mëdha brenda një kohe të shkurtër. Ekziston nevoja për më shumë përpjekje për të fuqizuar shoqërinë civile dhe

për të ngritur ura bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare me integritet, për të zvogëluar hapësirën që shfrytëzohet nga grupet kriminale.

Sipas një zyrtari policor të nivelit të lartë: "Jemi të vetëdijshëm që kemi probleme. Por jemi të përkushtuar ta luftojmë krimin. Për një kohë të gjatë, korrupsioni këtu në polici ishte standard, por tani po fryn era e ndryshimit."¹³

Shënime

1. Balkanski shopping u Arizoni, Nacional, 30 gusht 2019, <https://www.nacional.hr/balkanski-shopping-u-arizoni/>.
2. Tregu ka faqen e tij të internetit: <https://tobd.ba/objekti/313/trznica-arizona>.
3. M Nikolić, Arizona dream: Od šverca do proizvodnje, Radio Slobodna Evropa, 2 mars 2016, <https://www.slobodnaevropa.org/a/arizona-dream-od-sverca-do-proizvodnje/27585352.html>.
4. BILTEN Statistički podaci Brčko distrikta BiH, Agencija za statistiku BiH, 14 mars 2022, https://bhas.gov.ba/data/Publikacije/Bilteni/2022/BRC_00_2022_B1_1_BS.pdf.
5. Odličan učinak policijske akcije „KALIBAR“, Radio Brčko, 30 nëntor 2016, <https://radiobrcko.ba/arhiva/odlican-ucinak-policijske-akcije-kalibar/>; D B, Velika policijska akcija u Njemačkoj: Trojka iz BiH upletena u krađu vozila vrijednih 1,5 milion eura, Klix, 23 shkurt 2022, <https://www.klix.ba/vijesti/svijet/velika-policijska-akcija-u-njemackoj-trojka-iz-bih-upletena-u-krađu-vozila-vrijednih-1-5-miliona-eura/220223139>; A K dhe A B, Ko je bio meta akcije „Wolf“ u kojoj je učestvovalo 250 policajaca, Avaz, 16 dhjetor 2020, <https://avaz.ba/vijesti/crna-hronika/616880/ko-je-bio-meta-akcije-wolf-u-kojoj-je-ucestvovalo-250-policajaca>; Hapšenja u BiH i Austriji: Pali dileri droge i oružja, ATV BL, 29 maj 2016, <https://www.atvbl.rs/hapsenja-u-bih-austriji-pali-dileri-droge-o-oružja>; Velika akcija razbijanja lanca krijumčara droge i ljudi u Republici Srpskoj, dio robe redovno je završavao i u Hrvatskoj, Slobodna Dalmacija, 8 dhjetor 2021, <https://slobodnadalmacija.hr/vijesti/regija/velika-akcija-razbijanja-lanca-krijumcara-droge-i-ljudi-u-republici-srpskoj-dio-robe-redovno-je-završavao-i-u-hrvatskoj-1149492>.
6. Intervistë me një efektiv të lartë policor në Rrethin e Bërçkos, 14 janar 2022.
7. N N, Brčak optužen za 20 teških pljački i ranjavanja nožem, Nezavisne novine, 23 tetor 2017, <https://www.nezavisne.com/novosti/hronika/Brčak-optuzen-za-20-teskih-pljacki-i-ranjavanja-nozem/448468>.
8. S Bandić, Uhićeni muškarac pomoćnik šefa Krim-policije Brčko distrikta Zlatko Androšević, Zadarski list, 27 tetor 2018, <https://www.zadarskilist.hr/clanci/27102018/uhiceni-muskarac-pomocnik-sefa-krim-policije-brcko-distrikta-zlatko-androšević>.
9. E Redžić, Sedmorica policajaca suspendirana zbog napada na imovinu uglednog privrednika, Avaz, 18 prill 2019, <https://avaz.ba/vijesti/bih/477094/sedmorica-policajaca-suspendirana-zbog-napada-na-imovinu-uglednog-privrednika>.
10. Svečano otvorena nova zgrada Policije Brčko distrikta BiH, Vlada Brčko distrikta BiH, 17 shkurt 2016, <http://vlada.bdcentral.net/Publication/Read/svecano-otvorena-nova-zgrada-policije-brcko-distrikta-bih?lang=en.M>.
11. M N, Akcija Cer u Brčkom: Od 17 uhapšenih u pritvoru ostao samo jedan osumnjičeni, Klix, 24 tetor 2019, <https://www.klix.ba/vijesti/crna-hronika/akcija-cer-u-brckom-od-17-uhapsenih-u-pritvoru-ostao-samo-jedan-osumnjiceni/191024121>.
12. M M, "Bjegunac": Akcijom SIPA-e obuhvaćeno 15 osoba, među njima i policajci, Faktor, 22 nëntor 2021, <https://faktor.ba/vijest/bjegunac-akcijom-sipa-e-obuhvaceno-15-osoba-medu-njima-i-policajci/145052>.
13. Intervistë me një inspektor të lartë në Rrethin e Bërçkos, 8 janar 2022.

4. Zhvatja në Serbi është e nënvlerësuar dhe raportohet sikur është më pak nga sa është në të vërtetë.

Sa problem i madh janë zhvatja dhe fajdja në Serbi? Kjo është pyetja që Milos Katiçi, president ekzekutiv i bordit të Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur të Vojvodinës deshi t'i përgjigjej me anë të një hulumtimi në vitin 2021 falë një burse të Fondit të Qëndrueshmërisë të GI-TOC-së. I motivuar nga përvoja e tij personale në një komunitet të vogël, Katiçi analizoi reagimet e institucioneve dhe perceptimet e qytetarëve ndaj zhvatjes, dallaveve dhe fajdes në Serbi. Gjetjet e tij u publikuan në dhjetor të vitit 2021.¹

Dallimi kryesor midis zhvatjes dhe fajdes (edhe kur i referohemi si "kredi grabitqare") është se, në rastin e zhvatjes, kryerësi i veprës e detyron viktimën me qëllim që t'ia marrë pronën në mënyrë të paligjshme, ndërsa në rastin e fajdes, viktimë kërkon shërbime financiare nga kryerësi i veprës në formën e një kredie dhe më pas viktimë shfrytëzohet. Në kodin penal të Serbisë, shfrytëzimi konsiderohet vepër penale me natyrë pronësore. Ky koncept nënkupton qëllimin për të përfutur pasuri në mënyrë të paligjshme ose përfitime të tjera nëpërmjet dhunës ose kërcënimit. Dhuna mund të ushtrohet drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndërsa kërcënimi duhet të ketë intensitet të tillë që të krijojë të viktima ndjenjën e frikës. Kryerësi i veprës nuk duhet patjetër të ketë për qëllim që këtë përfitim ta marrë për vete. Zhvatja mund të kryhet edhe për përfitim të dikujt tjetër.

Sipas raportit të Katiçit, individët, në përgjithësi, zhvatin shuma relativisht të vogla parash nga njerëzit që janë në vështirësi financiare. Për shembull, grupet kriminale huligane që drejtojnë kompani të shërbimit të ruajtjes fizike në Beograd dhe Novi Sad shpesh u zhvatin mijëra euro restoranteve ose klubeve "për t'i mbrojtur". "Kjo është dallavere klasike", thotë Katiçi. "Pronarët paguajnë për t'u mbrojtur edhe pse nuk kanë kërkuar mbrojtje sepse kjo është e vetmja mënyrë për të punuar ose për të mos cenuar reputacionin."

Në studimin e tij, Katiçi arrin në përfundimin se zhvatja është e përhapur në Serbi, por nënvlerësohet. "Njerëzit në Serbi nuk e marrin seriozisht zhvatjen derisa u vjen atyre radha për t'u zhvatur. Kur ndodh kjo, ata nuk dinë

si të reagojnë." tha Katiçi. Gjithashtu, kjo është dukuri për të cilën njerëzit janë relativisht të painformuar. "Njerëzit dinë më shumë për dallaveret dhe fajden, ndoshta për shkak të telenovelave dhe filmave, por edhe sepse njohin më shumë viktimë ose autorë të këtij krimi", shpjegoi ai.

Në studimin e tij, ai vuri re një dallim të madh midis numrit të rasteve të raportuara dhe mënyrës se si i shohin qytetarët këto krime. Sipas Katiçit, njerëzit besojnë se sistemi juridik serb nuk do t'i mbrojë. Kjo është arsyeja pse "nuk është për t'u habitur që shumica e njerëzve kanë frikë të kallëzojnë në polici zhvatjen, dallaveret dhe fajden".

Ai shtoi: "Për shembull, një person mori hua 500 000 euro dhe ra dakord të paguajë një normë interesi. Kalon ca kohë dhe ai nuk arriti ta kthejë shumën. Kështu, për shkak të kredisë grabitqare, atij ia morën hotelin. Nisi procedura gjyqësore. Eksperti i gjykatës ia reduktoi vlerën e hotelit në 1 milionë euro, që nuk mjaftonin për të shlyer borxhin ndaj huadhënësit grabitqar, i cili kërkonte gjithmonë e më shumë para. Në fund, doli që huadhënësi grabitqar ishte duke punuar në mënyrë të organizuar dhe se ky nuk ishte i vetmi hotel që ai kishte përvetësuar. Ai kishte punësuar një ekip avokatësh që hartonin kontratat dhe kishin njohje me gjyqësorin."


Gjetjet e Katiçit nxjerrin në dritë faktin që njerëzit në qytete janë ata që guxojnë më shpesh që të kallëzojnë rastet e zhvatjes, sidomos kur zhvaten nga individë dhe jo nga grupe të organizuara. Nga ana tjetër, njerëzit në komunitetet e vogla kanë frikë sepse viktimë rrezikon të përballet me autorët e krimit. Në figurat 3 dhe 4 tregohet se më shumë se një e treta e të gjitha ankesave penale për zhvatje dhe fajde në Serbi janë bërë në kryeqytet, Beograd.

Në Ballkanin Perëndimor, dënimet më të larta për zhvatje janë në Serbi dhe Mal të Zi. Për këtë vepër penale parashikohet dënim me burg me deri në tetë vjet. Ndëshkimet më të buta janë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë, ku autorët e krimit dënohen me tre muaj burg.

Sipas Katićit, shumica e dallaveraxhinjve janë burra, edhe pse këtë praktikë e zbatojnë edhe gratë. Shpesh ata që i realizojnë skemat e dallaveve dhe zhvatjes janë të mitur. Bastoret janë vatra ku bëhen tok viktimat dhe autorët dhe ku realizohet rekrutimi i të miturve, sidomos në qytete.

Përfundimi që arrihet në studim është se ekziston nevoja për më shumë bashkëpunim midis medias dhe shoqërisë civile, për shkak të qasjes së bujshme të


shtypit ndaj kësaj teme. "Shtypi raporton për këto raste kryesisht kur ndodh ndonjë gjë tragjike. Ekziston nevoja për një qasje më profesionale. Profesionistët, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe median, duhet t'i parandalojnë këto krime dhe është e rëndësishme që në qendër të këtij parandalimi të jenë autorët e rinj të krimeve. Edukimi është çelësi. Besimi midis shoqërisë civile, medias dhe institucioneve shtetërore është e vetmja zgjidhje që mund të sjellë rezultate të vërteta", vuri në dukje Katić.



Numri i ankesave penale	
Beograd	345
Serbia e jugut dhe ajo lindore	235
Shumadija dhe Serbia e perëndimit	178
Vojvodina	185
Gjithsej	943

Figura 3 Ankesat penale për zhvatje në Serbi, sipas rajonit, 2016–2020.

Miloš Katić and Sanja Kosović, *Extortion and usury in Serbia between 2016 and 2020*, GI-TOC and Vojvodina Research and Analytical Center, December 2021, <https://voice.org.rs/wp-content/uploads/2021/12/Case-study-2021-1.pdf>



Numri i ankesave penale	
Beograd	109
Serbia e jugut dhe ajo lindore	57
Shumadija dhe Serbia e perëndimit	62
Vojvodina	82
Gjithsej	310

Figura 4 Ankesat penale për fajde në Serbi, sipas rajonit, 2016–2020.

Miloš Katić and Sanja Kosović, *Extortion and usury in Serbia between 2016 and 2020*, GI-TOC and Vojvodina Research and Analytical Center, December 2021, <https://voice.org.rs/wp-content/uploads/2021/12/Case-study-2021-1.pdf>

Shënime

1. Miloš Katić dhe Sanja Kosović, Extortion and Usury in Serbia between 2016 and 2020 [Zhvatja dhe fajtja në Serbi midis viteve 2016 dhe 2020], GI-TOC, dhjetor 2021, <https://voice.org.rs/wp-content/uploads/2021/12/Case-study-2021-1.pdf>.

5. Pretendimet për foshnja të zhdukura vazhdojnë të jenë makthi i Serbisë.

Tregjet kriminale shpesh i trajtojnë qeniet njerëzore si komoditete. Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore sillen dhe shitet kryesisht për punë të detyruar ose seks, ndërsa migrantët kontrabandohen kundrejt një çmimi, ndonjëherë në kushte ku humbin jetën. Ekziston madje edhe një treg i zi për foshnjat.

Gjatë 70 viteve të fundit, pretendohet se nga maternitetet në mbarë Serbinë janë zhdukur 10 000 foshnje në rrethana të dyshimta.¹ Historia është gjithmonë e njëjta: prindërve u thuhet se foshnja vdiq pas lindjes, por atyre nuk u lejohej ta shohin trupin e foshnjës dhe as u thuhet se ku është varrosur. Në vitin 2018, një nënë dëshmoi në lidhje me rastin që i kishte ndodhur në vitin 1988: “Erdhi një doktor dhe më tha... që më kishte vdekur foshnja. Më tha që do të ishte mirë që të mos e shihja foshnjën e vdekur sepse atë pamje nuk do ta harroja sa të isha gjallë.”²

Foshnjat filluan të zhdukeshin gjatë periudhës komuniste në ish-Jugosllavi. Në atë kohë, shumë prindër nuk mund ta imagjinonin mungesën e informacioneve rreth vdekjes së fëmijëve të tyre. Por në komunizëm, njerëzve nuk u lejohej ta vinin në pikëpyetje narrativën zyrtare.³ Një nënë bëri këtë vrotim: “Në atë kohë, në atë sistem, çdo grua që orvatej të akuzonte ndonjë doktor dhe të vinte në pikëpyetje vdekjen e papritur të fëmijës deklarohet e çmendur.”⁴

Për shumë vite, zhdukja e foshnjave nga pavijonet e materniteteve të Serbisë ishte sekret që e dinin të gjithë.⁵ Por kjo situatë ndryshoi në vitin 2013 kur nëna e një foshnje të zhdukur, Zorica Jovanović (Zorica Jovanović) fitoi një rast kundër Serbisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁶ Rasti i ishte paraqitur Gjykatës pasi autoritetet serbe i kishin mohuar vazhdimisht qasje Jovanovićit në informacione në lidhje me fatin e fëmijës së saj, i cili gjoja kishte vdekur në vitin 1983 ndërkohë që ishte në përkujdesjen e një spitali shtetëror. Rasti u përqendrua në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili parashikon të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Jovanović u dëmshpërblye me 10 000 euro për dëme jomateriale sepse gjykata konstatoi se Serbia kishte dështuar t'i jepte asaj informacione të besueshme në lidhje me fatin e të birit. Asaj nuk i ishte dorëzuar kurrë

trupin e të birit dhe as nuk ishte informuar se ku pretendohet se ishte varrosur. Krahës kësaj, vdekja e tij nuk ishte hetuar kurrë si duhet dhe as nuk ishte regjistruar në dokumente zyrtare. Gjithashtu, gjykata e urdhëroi Serbinë të merrte të gjitha masat për të krijuar një mekanizëm me qëllim ofrimin e korrigjimeve individuale për të gjithë prindërit që janë në një situatë të ngjashme.

Serbia arriti vetëm në vitin 2020 që të miratonte legjislacionin për foshnjat e zhdukura.⁷ Qeveria ngriti një komision për të mbledhur fakte për statusin e të gjithë fëmijëve të sapolindur që dyshohet se janë zhdukur nga maternitetet e Serbisë dhe për t'i kompensuar prindërit me deri në 10 000 euro. Në atë kohë, shumë njerëz dëshmuuan publikisht për rastet e tyre. Një nënë tregoi se si e llahtariste mendimi se dikush mund të varroste një fëmijë pa vënë në dijeni prindërit dhe vendosi të raportonte rastin e saj menjëherë pasi Serbia miratoi ligjin.

Deri më tani, gjithsej 694 aplikantë (kryesisht nga Beogradi) kanë dorëzuar kërkesa për të filluar procedurën për përcaktimin e fatit të foshnjave të sapolindura të cilat besohet se janë zhdukur nga një prej materniteteve të vendit.⁸ Ana Stamenići (Ana Stamenić), gjyqtare e Njesisë Speciale të Gjykatës së Lartë për Parandalimin e Korrupsionit në Novi Sad, vuri në dukje në korrik të vitit 2021 se, megjithëse është zgjidhur një rast, 99 të tjerë janë ende në pritje.⁹

Megjithatë, sa vjen e rriten shpresat për zgjidhjen e të paktën disa rasteve. Në shtator të vitit 2021, Mlagjan Radivojević (Mladan Radivojević), pasi bëri shumë analiza ADN-je, arriti të gjente prindërit e tij biologjikë dhe të provonte se ishte rrëmbyer nga spitali në Serbi para 40 vjetësh.¹⁰

Si organizohet TREGU?

Ndonëse nuk ka dyshim se vjedhja e foshnjave është vepër rrëqethëse, a mund të konsiderohet ajo lloj i krimit të organizuar? Konventa e Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” i përkufizon grupet kriminale si grupe të strukturuar me tre ose më shumë njerëz, të cilat ekzistojnë për një periudhë kohore me qëllim arritjen e fitimeve monetare të paligjshme.¹¹

Në Serbi, adoptimi i paligjshëm duket se është mënyra kryesore e vjedhjes së foshnjave nga prindërit e tyre biologjikë. Në këto raste, një grua që nuk ekziston, regjistrohet në dokumente si nënë. Më pas, përdoren dokumente të falsifikuara me të cilat ajo e jep fëmijën për adoptim.¹²

Procedura e paligjshme e adoptimit zgjat rreth një javë. Ky proces zakonisht realizohet nga agjencitë e ndërmjetësimit juridik ose avokatët që i pajisin blerësit me kontaktet e nevojshme. Për një tarifë prej rreth 10 000 dollarësh amerikanë (çmimi në vitin 1998)¹³, ata bëjnë të gjitha letrat dhe merren me dorëzimin, logjistikën dhe akomodimin.

Ndonjëherë, nga dëshmitë del se në procesin e falsifikimit të dokumenteve të fëmijës përfshihen edhe zyrtarë shtetërorë. Këta raportohet se kanë futur në listë gra joekzistente si nëna në dokumente zyrtare ose kanë krijuar dokumente ku nëna heq dorë nga foshnja dhe e jep për adoptim.¹⁴ Ndonjëherë, gabimet kanë nxjerrë në dritë bashkëfajësinë e tyre, p.sh. në rastet kur fëmijët pa emra dhe mbiemra ose pa emrat e prindërve ishin regjistruar në dokumente zyrtare, vepër kjo që bie ndesh me ligjin.¹⁵ Ka pasur edhe raste ku kompanitë e funeraleve deklarorin se fëmija që gjoja ka vdekur nuk mbërriti kurrë te varrezat dhe se nuk është varrosur ose djegur.¹⁶ Në një incident tjetër, u zbulua se skedarët për 29 foshnja të adoptuara midis viteve 1976 dhe 1981

ishin zhdukur nga ambientet e një qendre serbe për punë sociale.¹⁷

Është raportuar se pjesëmarrës në këto skema janë edhe doktorët. Një grua amerikane, që adoptoi një foshnje nga Serbia në vitin 1998, pohoi se i kishte paguar një doktor 2 800 dollarë amerikanë dhe i kishte dhuruar 1 000 dollarë amerikanë një materniteti për të lehtësuar procedurën e adoptimit.¹⁸ Ka pasur edhe raste ku doktorët pretendohet se kanë ndërmjetësuar për shitjen e paligjshme të fëmijëve ose kanë nënshkruar certifikatat e lindjes dhe vdekjes së fëmijëve.¹⁹ Në një letër nga një maternitet në Novi Sad thuhej se në vitin 2019 në maternitet kishte pasur 72 lindje të vdekura dhe se të gjithë foshnjat ishin dërguar në një varrezë të caktuar. Megjithatë, shërbimi i varrezave deklaronte se në vitin 2019 kishte pranuar trupat e vetëm 15 foshnjave të vdekura nga ky maternitet.²⁰ Duke marrë parasysh bashkëpunimin e dukshëm midis avokatëve, doktorëve dhe zyrtarëve shtetërorë, këto skema adoptimi mund të konsiderohen si lloj i krimit të organizuar.

Një problem më i gjerë

Ky krim nuk është krim që ndodh vetëm në Serbi. Për shembull, midis viteve 1950 dhe 1990, në Spanjë, më shumë se 50 000 foshnja raportohet se u janë vjedhur nënave.²¹ Mënyra e veprimit ishte e ngjashme me atë në Serbi: nënës biologjike i thuhej se foshnja kishte vdekur pak kohë pas lindjes, ndërkohë që fëmija i sapolindur



Protestë e vitit 2019 në Serbi për denoncimin e rasteve në pritje të foshnjave të zhdukura.

Fotoja: N1

ishte dhënë për adoptim, në mënyrë të tillë që dukej sikur prindërit birësues ishin prindërit biologjikë.²²

Ekziston nevoja për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për t'i vënë fre adoptimit të paligjshëm në mbarë botën. Pas një kërkese zyrtare, në shkurt të vitit 2021, Holanda pezulloi të gjitha adoptimet nga jashtë vendit.²³ Krahas kësaj, në gusht të vitit 2021, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Zhdukjet e Detyruara e detyroi Zvicrën të hetonte adoptimet e paligjshme nga Sri Lanka të cilat ishin bërë përgjatë 3 dekadash, duke filluar në vitet 1970.²⁴ Dikush mund të shpresojë se tani që Serbia ka miratuar ligjin e ri dhe po i kushton më shumë vëmendje

këtij krimi në vend dhe jashtë shtetit, rreziku i zhdukjes së foshnjave do të ulet në të ardhmen.

Megjithatë, duket se po shfaqet një rrezik tjetër: një treg i zi për embrionet në Serbi dhe në Ballkan.²⁵ Në vitin 2019, policia në Greqi gjurmoi 24 shitje embrionesh.²⁶ Presidenti i Shoqatës së Foshnjave të Zhdukura të Vojvodinës i ka paralajmëruar prindërit se Serbia nuk është immune ndaj këtij krimi.²⁷ Edhe pse është e vështirë ta besosh, tregu i foshnjave të vjedhura mund të plotësohet me një treg embrionesh të vjedhura, treg ky që është duke u shfaqur.²⁸

Shënime

1. Pas muajsh të tërë hetimi, i cili mbuloi disa ministri, autoritete të vetëqeverisjes lokale dhe institucione të kujdesit shëndetësor dhe institucione të tjera, Avokati i Popullit i Serbisë identifikoi një numër lëshimesh në punën e autoriteteve publike kompetente dhe të institucioneve me kompetenca publike, të cilat renditen në pjesët përkatëse të "Raportit të Mbrojtësit të Qytetarëve për të ashtuquajturit "raste të foshnjave të zhdukura" me rekomandime", Mbrojtësi i Qytetarëve, Beograd, 29 korrik 2010, <https://www.ombudsman.org.rs/attachments/article/117/Missing%20babies%20cases%20report%20-%20Serbian%20ombudsman.doc>.
2. Adriana Jankovic, 'Idi kuçi, radaćeš još Potresne ispovesti roditelja koji sumnjaju da su im deca ukradena u porodilištu, Blic, 12 shkurt 2018, <https://www.blic.rs/vesti/drustvo/idi-kuci-radjaces-jos-potresne-ispovesti-roditelja-koji-sumnjaju-da-su-im-deca-ukradena-ls1hl1f>.
3. Missing Babies [Foshnjat e zhdukura], Off The Grid, TRT World, 18 shkurt 2020, <https://www.youtube.com/watch?v=KXDPx7YFWnk>.
4. Adriana Jankovic, 'Idi kuçi, radaćeš još Potresne ispovesti roditelja koji sumnjaju da su im deca ukradena u porodilištu, Blic, 12 shkurt 2018, <https://www.blic.rs/vesti/drustvo/idi-kuci-radjaces-jos-potresne-ispovesti-roditelja-koji-sumnjaju-da-su-im-deca-ukradena-ls1hl1f>.
5. Alternative Report on the implementation of the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights in Serbia and Montenegro [Raporti alternativ për zbatimin e konventës ndërkombëtare "Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore në Serbi dhe Mal të Zi"], ASTRA, 2005, <https://www.astra.rs/en/alternative-report-committee-economic-social-cultural-rights-2005/>.
6. Zorica Jovanović v. Serbia, Kërkesa nr. 21794/08, GJEDNJ, 9 shtator 2013, <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22appno%22%3A%2221794%22%22%22documentcollectionid%22%3A%22JUDGMENTS%22%22DECISIONS%22%22itemid%22%3A%22001-118276%22%7D>.
7. Zyrtarisht, ai njihet me emrin "ligji "Për përcaktimin e fakteve rreth statusit të fëmijëve të sapolindur që dyshohet se janë zhdukur nga maternitetet në Republikën e Serbisë".
8. Zorica Jovanović v. Serbia, Kërkesa nr. 21794/08, ECHR, 9 shtator 2013, gjendja e ekzekutimit, <https://hudoc.exec.coe.int/ENG?i=004-7011>.
9. U novosadskom sudu navala je sudskih sporova o nestalim bebama, Dnevnik, 8 korrik 2021, <https://www.dnevnik.rs/hronika/u-novosadskom-sudu-najezda-sudskih-predmeta-o-nestalim-babama-08-07-2021>.
10. Ljiljana Raičević, "Sad imam sestru, majku, brata i znam čiji sam" – jedan slučaj oteht beba danas dobio epilog, Radio Television Serbia, 30 shtator 2021, <https://www.rts.rs/page/stories/sr/story/125/drustvo/4533049/bebi-afeta-otet-bebe-epilog-sud-krusevac.html>.
11. Përkufizimi i plotë jepet në nenin 2 (a) të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar": "Grup i krimit të organizuar" është një grup i strukturuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, që ekziston për një periudhë kohe dhe ku anëtarët veprojnë në bashkërendim me qëllim kryerjen e një ose më shumë krimeve ose veprave të rënda penale, të parashikuara në këtë Konventë, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përfitime financiare ose përfitime të tjera materiale." <https://www.unodc.org/documents/treaties/UNTOC/Publications/TOC%20Convention/TOCebook-e.pdf>.
12. Slavica Tuvic, Mladan iz Adrana kaže da je pronašao biološke roditelje i da je to prvi razrešen slučaj afere „nestalih beba", Euronews Serbia, 1 tetor 2021, <https://www.euronews.rs/srbija/drustvo/19055/mladan-iz-adrana-kaze-da-je-pronasao-bioloske-roditelje-i-da-je-to-prvi-razresen-slucaj-afere-nestalih-beba-vest>.
13. Amerikanka priznala da je kupila bebu iz Srbije, platili 10.000 dolara, Večernji list, 22 tetor 2020, <https://www.vecernji.ba/vijesti/amerikanka-priznala-da-je-kupila-bebu-iz-srbije-platili-10-000-dolara-1440487>.
14. V. Crnjanski Spasojevic, Ukradeno 29 dosijea o "nestalim bebama", Novosti, 21 maj 2019, <https://www.novosti.rs/vesti/naslovna/drustvo/aktuelno.290.html:795819-Ukradeno-29-dosijea-o-nestalim-babama>.
15. Trafikimi i qenieve njerëzor në Republikën e Serbisë, Raporti për periudhën 2000-2010, ASTRA, 2011, <https://www.astra.rs/en/human-trafficking-serbia-report-period-2000-2010/>. Skanimet e disa prej dokumenteve që përmbajnë lëshimet e përmendura mund të gjenden në librin: Ristović M., Trgovina bebama u Srbiji-rođeni da nestanu. Nis: Ristović M.2006, pg 20, 53, 89, 92, http://www.kradjabeba.org/files/knjiga_rodeni%20da%20nestanu.pdf; Report of the Board of Inquiry Charged with Ascertaining the Truth about New-born Babies Abducted from Maternity Wards in Several Serbian Cities (2005) [Raporti i Bordit Hetimor të ngarkuar me zbardhjen e së vërtetës për foshnjat e sapolindura të rrëmbyera nga maternitetet në disa qytete të Serbisë] - Raport nga Bordi Hetimor i krijuar nga parlamenti i republikës me qëllim që të ndihmojë prindërit që besojnë se foshnjat e tyre të sapolindura janë zhdukur. Në raportin

- e tij, Bordi përshkruan vëzhgimet e bëra duke u mbështetur në hetime dhe intervista me një numër prindëresh në seanca private.
16. The 'missing babies' scandal [Skandali i "foshnjave të zhdukura"], European Implementation Network, 5 dhjetor 2019, <https://www.einnetwork.org/blog-general/2019/12/5/the-missing-babies-scandal>.
 17. V. Crnjanski Spasojevic, Ukradeno 29 dosjeja o "nestalim bebama", Novosti, 21 maj 2019, <https://www.novosti.rs/vesti/naslovna/drustvo/aktuelno.290.html:795819-Ukradeno-29-dosjeja-o-nestalim-bebama>.
 18. Amerikanka priznala da je kupila bebu iz Srbije, platili 10.000 dolara, Večernji list, 22 tetor 2020, <https://www.vecernji.ba/vijesti/amerikanka-priznala-da-je-kupila-bebu-iz-srbije-platili-10-000-dolara-1440487>.
 19. Ana Jankovic Jovanovic, The 'missing babies' scandal [Skandali i "foshnjave të zhdukura"], European Implementation Network, 5 dhjetor 2019, <https://www.einnetwork.org/blog-general/2019/12/5/the-missing-babies-scandal>.
 20. Bez Ustrucavanja: Ana Pejić i Dragoslava Šaponja - dokazi o krađi beba u Srbiji postoje!, 11 nëntor 2020, <https://www.youtube.com/watch?v=oReNLEmzo8A&t=1085s>.
 21. Graham Keeley, More than 50,000 babies stolen from Spanish mothers under Franco era laws [Më shumë se 50 000 foshnja u janë vjedhur nënave spanjolle gjatë kohës së ligjeve të Frankos], Independent, 16 mars 2021, <https://www.independent.co.uk/news/world/europe/spain-babies-mothers-stolen-law-franco-b1817860.html>.
 22. Cristina Fernández-Pacheco Estrada, On the prosecution of "stolen babies" cases in Spain [Mbi ndjekjen penale të rasteve të "foshnjave të vjedhura" në Spanjë], Criminal Law Forum, 31, 415–460.
 23. Dutch suspend foreign adoptions after abuses found [Holandezët pezullojnë adoptimet nga jashtë vendit pas zbulimit të abuzimeve], BBC, 8 shkurt 2021, <https://www.bbc.com/news/world-europe-55982542>.
 24. Dorian Burkhalter, UN body puts illegal adoptions in new, criminal light [Organi i OKB-së i vendos adoptimet e paligjshme nën një dritë të re penale], Swissinfo.ch, 30 gusht 2021, <https://www.swissinfo.ch/eng/un-body-puts-illegal-adoptions-in-new-criminal-light/46905860>.
 25. Proverava se anonimna prijava: Da li su pojedini tužioc i funkcioneri u BiH umešani u nezakonitu trgovinu jajnim ćelijama?, Blic, 5 maj 2018, <https://www.blic.rs/vesti/republika-srpska/proverava-se-anonimna-prijava-da-li-su-pojedini-tuzioci-i-funkcioneri-u-bih-umesani-u-5tt984v>; Crno tržište embriona u Srbiji Žene kupuju plod za 5.000 evra, a to sa sobom nosi seriju opasnosti, Blic, 20 maj 2018, <https://www.blic.rs/vesti/drustvo/crno-trziste-embriona-u-srbiji-zene-kupuju-plod-za-5000-evra-a-to-sa-sobom-nosi/17fqs3k>; Embrije iz BiH švercali i u Izrael, pokrenuta istraga, VL, 30 janar 2014, <https://www.vecernji.ba/crna-kronika/embrije-iz-bih-svercali-i-u-izrael-pokrenuta-istraga-918089>; Sumnje u šverc jajnih ćelija!, Novosti, 2 prill 2013, <https://www.novosti.rs/vesti/naslovna/hronika/aktuelno.291.html:427487-Sumnje-u-sverc-jajnih-celija>.
 26. Afera "nestale bebe" u Grčkoj Uhapšeno 12 osoba, osumnjičeni odbacuju optužbe, Blic, 28 shtator 2019, <https://www.blic.rs/vesti/svet/afere-nestale-bebe-u-grckoj-uhapsheno-12-osoba-osumnjiceni-odbacuju-optuzbe/30e2elg>.
 27. Ko nam i dan danas krade bebe u Srbiji?, Posle rucka, Tv Happy, 28 prill 2021, <https://www.youtube.com/watch?v=-tcmjvK2LOE&t=4900s>.
 28. Elvira Krithari, Making babies, pushing boundaries: The great Greek fertility market [Bërja e fëmijëve, shtyrja e kufijve: Tregu i madh grek i fertilitetit], Balkan Insight, 9 korrik 2021, <https://balkaninsight.com/2021/07/09/making-babies-pushing-boundaries-the-greek-fertility-market/>; Top Italian fertility doctor Severino Antinori arrested [Arrestohet Severino Antinori, doktori më i mirë i Italisë në fushën e fertilitetit], BBC, 14 maj 2016, <https://www.bbc.com/news/world-europe-36293549>; Proverava se anonimna prijava: Da li su pojedini tužioc i funkcioneri u BiH umešani u nezakonitu trgovinu jajnim ćelijama?, Blic, 5 maj 2018, <https://www.blic.rs/vesti/republika-srpska/proverava-se-anonimna-prijava-da-li-su-pojedini-tuzioci-i-funkcioneri-u-bih-umesani-u-5tt984v>; Tužiteljstvo: Sud je teško pogriješio oslobodivši Asima Kurjaka, Jutarnji, 2 gusht 2009, <https://www.jutarnji.hr/vijesti/tuziteljstvo-sud-je-tesko-pogrijesio-oslobodivsi-asima-kurjaka-2829317>; UC Irvine fertility scandal isn't over [Nuk ka të mbaruar skandali i fertilitetit në qendrën "UC"], LA Times, 20 janar 2006, <https://www.latimes.com/archives/la-xpm-2006-jan-20-me-uci20-story.html>.

Lajmet Më Të Fundit Nga Observatori i Ekonomive Të Paligj-shme Në Evropën Juglindore

ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË ZBULIMIN E PRURJEVE FINANCIARE TË PALIGJSHME

Në një raport të ri të GI-TOC-së për PFP-të në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi vihet në dukje nevoja për rritjen e informimit për ndikimin dhe dëmin që shkaktojnë PFP-të dhe për rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile për të hetuar dhe rritur vetëdijesimin për këto lloje krimi. Në këtë raport vihet në dukje mënyra se si PFP-të nxirren nga këto tri ekonomi për shkak të korrupsionit, evazionit fiskal dhe krimit të organizuar.

Sistemi financiar është kanali kyç përmes së cilit lëvizin të ardhurat e paligjshme. Të tri vendet kanë sektorë të konsiderueshëm bankarë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të gjitha kanë probleme me pastrimin e parave. Përlllogaritet se vetëm në vitin 2020 të jetë pastruar rreth 2 deri në 5% e PBB-së. Pjesa më e madhe e këtyre parave shkon në sektorin e pasurive të paluajtshme, turizmit dhe bizneseve që përdorin para fizike.

Të tre vendet i kanë kushtuar vëmendje të madhe PFP-ve duke shtuar përpjekjet kundër korrupsionit, duke përmirësuar qeverisjen financiare dhe transparencën e sektorit publik. Pavarësisht kësaj, ndikimi i tyre dëmtuar duket se nuk kuptohet sa duhet as nga shoqëria civile dhe as nga faktorët qeveritarë. Ekziston nevoja që shoqëria civile të rrisë sasinë dhe cilësinë e të dhënave të disponueshme për të gjithë përbërësit dhe kanalet e PFP-ve dhe të nisë dialogun me zyrtarët shtetërorë, sektorin privat dhe publikun e përgjithshëm në lidhje me këtë temë.

Shoqëria civile në Ballkanin Perëndimor mund të mos ketë ende ekspertizë thelbësore në lidhje me PFP-të, por ajo përbën një grup të rëndësishëm palësh të interesuara që duhet të angazhohet duke ofruar të dhëna dhe prova për politikën e reja, mbikëqyrje dhe monitorim të përparimit të qeverisë, si dhe duke rritur vetëdijesimin e publikut.


Ky raport është vazhdim i publikimit të një vlerësimi të ngjashëm në vitin 2020 ku analizoheshin faktorët kyç të nxitjes dhe prirjet aktuale të PFP-ve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të Veriut.¹



VEGLA E RE NË INTERNET GJURMON KONTRABANDIMIN E MIGRANTËVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në vitin 2015, vlerësohet se 1,5 milionë azilërkues dhe migrantë—të nxitur pjesërisht nga luftërat në Siri dhe Irak—kaluan nëpër Turqi dhe Greqi për të arritur në Ballkanin Perëndimor dhe, prej këtej, drejt Evropës Perëndimore. Deri më sot, Ballkani Perëndimor vazhdon të jetë vatrë për emigrantët që përpiqen të arrijnë në Evropën Perëndimore.

Në vitin 2021, GI-TOC-ja analizoi tregun e kontrabandimit të migrantëve në një raport të titulluar “Çmimet në pikat kyçe: Analiza e flukseve të njerëzve, drogës dhe parave në Ballkanin Perëndimor”.² Në kuadër të studimit përcjellës, duke marrë parasysh natyrën dinamike të tregjeve kriminale, GI-TOC-ja ka zhvilluar një vegël ndërevepruese në internet, e cila paraqet një panoramë të trafikimit të migrantëve në rajon.



Kjo vegël ofron të dhëna për kalimet e parregullta të kufirit përgjatë rrugës së Ballkanit, numrin dhe kombësinë e migrantëve dhe azil-kërkuesve, fitimet e përlllogaritura të tregut të kontrabandimit të migrantëve dhe një hartë ndërvepruese ku shfaqen rrugët e kontrabandimit dhe çmimet që paguhën për secilën rrugë.

Kjo vetëm, e cila ka një konfigurim të lehtë për t'u përdorur dhe përditësohet herë pas here, është e disponueshme për publikun, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, mediat, analistët, studentët dhe autoritetet e zbatimit të ligjit. Përdoruesit mund të

bashkëndajnë me rrjetet e tyre në mediet sociale të gjithë veglën dhe/ose pjesë specifike dhe grafikë.

Kjo është vegla e parë e një vargu veglash analitike ndërvepruese të zhvilluara nga Observatori, të cilat kanë për synim jo vetëm ofrimin e një mënyre alternative të publikimit të gjetjeve të hulumtimeve, por edhe nxitjen e dialogut të mbështetur në analizë, politikave dhe vetëdijesimit në radhët e palëve të interesuara.

Për ta përdorur mjetin, vizitoni linkun:

<https://globalinitiative.net/analysis/migrant-smuggling-western-balkans>.

SHËNIME

1. Tuesday Reitano dhe Kristina Amerhauser, Prurjet financiare të paligjshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut: Faktorët kryesorë dhe prirjet aktuale, GI-TOC, gusht 2020, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/08/Prurje-Financiare-Te%CC%88-Paligjshme-Ne%CC%88-Shqipe%CC%88i-Kosove%CC%88-Dhe-Maqedonine%CC%88-E-Veriut-Faktore%CC%88t-Kryesore%CC%88-Dhe-Prirjet-Aktuale.pdf>.
2. Walter Kemp, Kristina Amerhauser dhe Ruggero Scaturro, Çmimet në pikat kyçe: Analiza e flukseve të njerëzve, drogës dhe parave në Ballkanin Perëndimor, GI-TOC, maj 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/Hotspots3_PR_AL.docx.

Mirënjohe

“Buletini i rreziqeve” është rezultat i punës së Observatorit të Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore (“SEE-Obs”) të Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.

SEE-Obs-ja është platformë që bashkon dhe fuqizon aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Qëllimi i platformës është t’i mundësojë shoqërisë civile të identifikojë, analizojë dhe vendosë në hartë prirjet kriminale dhe ndikimin që ato kanë në prurjet e paligjshme financiare, qeverisje, zhvillim,

marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe shtetin ligjor. SEE-Obs-ja mbështet shoqërinë civile në monitorimin që ajo u bën dinamikave kombëtare dhe prirjeve më të gjera rajonale dhe ndërkombëtare të krimit të organizuar. Platforma “SEE-Obs” u themelua si rezultat i Samitit të vitit 2018 të Vendeve të Ballkanit në Londër, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Përfitojmë nga rasti të falënderojmë Safet Musiqin (Safet Musić), Rusmin Hërnjiqin (Rusmin Hrnjić), Milosh Katiqin (Miloš Katić) dhe Ana Profoziqin (Ana Profozić) për kontributet e tyre të vyera.

“Buletinet e rreziqeve” janë publikime periodike të vëzhguesve tanë rajonalë, të cilët mbështeten në rrjetet e shoqërisë civile për të siguruar të dhëna të reja dhe për të vënë në kontekst prirjet që kanë të bëjnë me rrjetet e krimit të organizuar, tregtinë e paligjshme dhe reagimin shtetëror ndaj tyre. Nëse dëshironi të abonoheni për numrat e ardhshëm të “Buletinit të rreziqeve”, ju lutemi të regjistroheni këtu ose të na dërgoni një email në adresën: almedina.dodic@globalinitiative.net.

MBI “INCIATIVËN GLOBALE”

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga mbi 500 ekspertë nga e gjithë bota. “Iniciativa Globale” ofron një platformë për të nxitur një debat më të gjerë dhe qasje novatore, duke krijuar kështu një bazë të shëndoshë për hartimin e një strategjie globale gjithëpërfshirëse kundër krimit të organizuar.

www.globalinitiative.net

Ky botim u bë i mundur falë përkrahjes financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konfliktin, Stabilitetin dhe Sigurinë. Lënda e botimit është përgjegjësi vetëm e GI-TOC-së dhe nuk pasqyron patjetër pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME